



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR

2019

Përmbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTESAT.....	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. KORNIZA LIGJORE.....	7
2.1. Baza ekzistuese ligjore e cila rregullon funksionimin e ARRU:.....	7
2.2. Vështirësitë ligjore :	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	9
3.1. Vizioni/Misioni	9
3.2. Kompetencat e ARRU.....	9
4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT.....	11
4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit	13
4.2. Bordi	14
4.3. Ekzekutivi.....	14
4.4. Burimet Njerëzore	14
4.5. Asetet	14
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE.....	15
5.1. Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L - 042	15
5.2. Harmonizimi i akteve nënligjore (Rregulloreve) me Ligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për shërbimet e ujit (Ligji Nr.06/L – 088)	15
5.3 Aprovimi i Planeve të ofruesve të shërbimeve	15
5.4. Rishikimi i tarifave për vitin 2020.....	16
5.5. Tarifat për shërbimet e ujit me shumicë.....	18
5.6 Tarifat për Mitrovicën e Veriut	19
5.7. Politikat tarifore	20
5.8. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave).....	20
5.8.1 Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve.....	20
5.8.2. Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative	21
5.8.3. Përmbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit.....	22
5.8.4. Përmbushja e caqeve të investimeve kapitale.....	22
5.9. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit	22
5.9.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit	23
5.9.2. Prodhimi i uji, shitjet dhe uji pa faturuar	25
5.9.3. Eficienca e faturimit dhe arkëtimit	26

5.9.3.1 Shkalla e arkëtimit.....	27
5.9.4. Kualiteti i Ujit.....	27
5.9.5. Matja e ujit.....	28
5.9.6.Efikasitet i stafit.....	29
5.9.7. Investimet kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	29
5.9.8 Performanca e NHE-Ibër Lepenci.....	30
5.10. Inspektimi i zbatimit të standardeve të shërbimit dhe legjislacionit aktual.....	31
5.10.2. Inspektimi i përmbushjes e standardeve të shërbimit dhe kushteve tjera të Licencës.....	32
5.10.3. Inspektimet tematike (At-hok) dhe sipas kërkesave.....	32
5.11. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve dhe Komisionit për Zgjedhjen e Ankesave të Konsumatorëve	33
5.12. Aktivitetet në konsolidimin institucional	36
5.12.1. Aktivitetet në planin legjislativ.....	36
5.14. RELACIONET ME PUBLIKUN	39
5.14.1. Bashkëpunimi me media.....	39
6. REKOMANDIMET.....	40
7. RAPORTI FINANCIAR	41
TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2019.....	42
8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	43

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

AKMM – Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

AMK – Agjencin e metrologjisë së Kosovës

ARRU – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

BB – Banka Botërore

DANUBIS – programi i benchmarkingut të vendeve të regjionit të Danubit

DWP – Danube Water Program (Programi i Ujërave të Danubit)

ERRU – Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (Shqipëri)

ESK – Enti i Statistikave të Kosovës

IBNET – International Benchmarking Netëork (Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarkingut)

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

IWAD – Shoqata ndërkombëtare e kompanive të ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub

GNI- Grupi Ndërinstitucional(KNMU, ARRU, NJPM-NP, SHUKOS, IKSHPK, KRU)

KBPZHRMPH – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

KE – Komisioni Europian

KK – Kuvendi Komunal

KKK – Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

KNMU – Këshilli Ndërministror i Ujit

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjellësit

MIE – Ministria e Integrimeve Evropiane

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NHE – Ndërmarrje Hidro Ekonomike

Nj.O. – Njësia Operative

NJPM – Njësia për Politika e Monitorim

SHUKALB – Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve Shqipëri

SHUKOS – Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës

TKP – Treguesit Kyç të Performancës

ZKA – Zyra Kombëtare e Auditimit

WAREG – Shoqata e Rregullatorëve Evropian të Ujit

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të nderuar/a,

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Ligji Nr. 05/L-042), përmes këtij Raporti Vjetor të Punës ju paraqesim aktivitetet e Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU) të zhvilluara gjatë vitit 2019. Ky raport gjithashtu përmes disa prej treguesve kyç paraqet edhe zhvillimet kryesore në sektorin e ujit sa i përket gjendjes së nivelit të shërbimeve të cilat ofrohen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Ngritja e nivelit të shërbimeve të ujit, mbrojtja e interesit të konsumatorëve dhe kujdesi për qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve kanë vazhduar të jenë objektivat kryesore të ARRU, objektiva këto të parapara edhe me Planin e Punës dhe Planin Strategjik të ARRU. ARRU ka shërbyer si promotor për përmirësimin e performancës së ofruesve të licencuar të shërbimeve, rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve dhe të përballueshme financiarisht, duke qenë gjithmonë transparent me publikun.

ARRU është institucion rregullator eficient i cili:

- Zhvillon funksione shtetërore jo qeveritare;
- Ofron kapacitete teknike dhe organizative,
- Ka një strukturë organizative të vogël me gjithsej 21 të punësuar,
- Nuk përfiton nga ndëshkimet (gjobat) financiare të cilat u shqipton ofruesve të shërbimeve.

Në vijim në pika të shkurtra janë paraqitur aktivitetet kryesore të ARRU:

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 06/l -088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, ARRU ka harmonizuar legjislacionin sekondar përmes nxjerrjes së rregulloreve të reja apo amandamentimin (plotësim ndryshimin) e atyre ekzistuese.

Nga obligimet e procesit rregullator të periudhës tarifore 2018-2020, fillimisht është aplikuar tarifa e aplikimit për vitin 2019, me mundësi rishikimi të jashtëzakonshëm ose të rregullt të tarifave të vitit 2019.

Tarifat vëllimore të shërbimeve të furnizimit me ujë të vitit 2019 për konsumatorët shtëpiak në nivel të sektorit, nuk kanë ndryshuar në krahasim me tarifat e vitit 2018, kurse tek konsumatorët jo-shtëpiak është bërë ulje e tarifave vëllimore, si rezultat i uljes të shkallës së ndër - subvencionimit sektorial.

Si çdo vit edhe gjatë vitit 2019 përmes Raportit të Performancës, ARRU ka vlerësuar ecurinë dhe ngecjet e ofruesve të shërbimeve të ujit. Informatat, analizat dhe të dhënat e Raportit të Performancës së ofruesve të licencuar të shërbimeve pasqyrojnë gjendjen e sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Përmes inspektimeve të vazhdueshme gjatë vitit 2019, ARRU ka përcjellë përmbushjen e Standardeve Minimale të Shërbimit dhe zbatimin e vendimeve rregullatore nga ana e ofruesve të shërbimeve, dhe është siguruar që ofruesit e shërbimeve të zhvillojnë aktivitetet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi. Si rezultat i parregullsive të gjetura, ofruesit e shërbimeve janë obliguar të respektojnë legjislacionin në fuqi me qëllim të përmbushjes së standardeve të shërbimit dhe në rastet kur është gjetur se konsumatorët janë dëmtuar të njëjtit janë kompensuar.

Mbështetja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve të cilat kanë qenë të themeluara me qëllim të zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve, ka vazhduar si një ndër aktivitetet e ARRU në gjysmën e parë të vitit 2019. Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nnr. 06/l -088 këto komisione janë shuar, dhe po në bazë të këtij ligji ARRU ka themeluar Komisionin për zgjidhjen e ankesave i cili merret me shqyrtimin dhe zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve të pakënaqur me përgjigjet nga ofruesit e shërbimeve.

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, edhe gjatë vitit 2019 ka vazhduar të përkrahet nga Projekti Mbështetës, i cili është pjesë integrale e Programit Mbështetës për Ujësjellës dhe Kanalizim në Zonat Rurale në Kosovë - Faza e VI, financuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Agjensisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). Qëllimi i Projektit është që të mbështes përmirësimin e menaxhimit në sektorin e ujit, me ç'rast janë ndërmarr disa aktivitete si: hartimi i Modullit të Balancit me Ujë; udhëheqja e aktiviteteve të inspektiveve dhe përdatësimit të "Modullit për përmbushjen e standardeve dhe kushteve tjera të Licencës" dhe përpilimit të Raportit për përmbushjen e standardeve dhe kushteve tjera të Licencës. Janë mbajtur punëtori dhe trajnime për përfaqësuesit e ofruesit të shërbimeve dhe stafin e ARRU, kryesisht për zhvillimin e mëtejshëm të sistemeve elektronike për ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave, menaxhimin e borgjeve të vjetra, implementimin e strukturave unike të kostove etj.

ARRU ka vazhduar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin me institucionet dhe aktorët kryesorë të fushës në vend edhe gjatë vitit 2019: me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor (KBPZHRMPH), Njësinë për Politika e Monitorim (NJPM/MZHE), Këshillin Ndërmnistror të Ujit (KNMU), Ministrinë e Integriteteve Evropiane (MIE), IKSHPK, etj.

Në funksion të rritjes së kapaciteteve dhe të cilësisë së aktivitetit të saj, ARRU ka intensifikuar bashkëpunimin me WAREG (Shoqata Evropiane e Rregullatorëve të Ujit), ku ARRU është anëtare me të drejta të plota, me Programin e Danubit financuar nga Banka Botërore, IWA (Shoqata Ndërkombëtare e Ujit), si dhe marrëdhëniet dypalëshe me rregullatorët në rajon, si Shqipëria, Maqedonia, Mal i Zi dhe ato të Evropës.

Përmes pjesëmarrjes aktive në takime dhe punëtori të organizuara brenda dhe jashtë vendit, kemi promovuar vendin, kemi dhënë kontribut duke prezantuar përvojat tona, si dhe kemi marrë përvojat e mira të institucioneve tjera.

ARRU, në përmbushje të obligimeve ligjore kundrejt sektorit dhe konsumatorëve, do të rrisë angazhimin për të forcuar pavarësinë, transparencën, profesionalizmin, bashkëpunimin ndër institucional brenda dhe jashtë vendit në mënyrë të tillë që me autoritetin e vet rregullator të krijojë ekuilibrin e duhur midis ofruesve të shërbimit, politikëbërësve dhe konsumatorit.

Pavarësia e Rregullatorit ka ndikuar që përmes aktiviteteve të zhvilluara dhe vendimmarrjeve të drejtpërdrejta të menaxhmentit të ARRU të përmirësohet niveli i shërbimeve të ujit dhe qëndrueshmëria e ofruesve të shërbimeve.

Falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbështetjen e tyre, stafin e ARRU për angazhimin, ofruesit e shërbimeve për punën dhe bashkëpunimin, projektin mbështetës të ARRU (financuar nga Qeveria e Kosovës dhe Qeveria Zvicerane) dhe të gjithë bashkëpunëtorët e këtij sektori për kontributin e dhënë me qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimeve të ujit.



Raif Preteni

2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 “Ligji për Ndryshimin e Rregullores 2004/49 mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave” të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, me ç’rast raportimi i ZRRUK (emërtim i mëhershëm) nga UNMIK-u ka kaluar te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060) më 08 qershor 2012, përgjegjësitë dhe kompetencat e sektorit të mbeturinave janë bartur te Qeveria e Kosovës dhe MMPH, pra që nga miratimi i këtij Ligji, Rregullatori ka pushuar së qeni përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të Ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Me qëllim të harmonizimit me Ligjin për Mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060) është amendamentuar Ligji Nr. 03/L-086.

Nga 30 janar 2016, baza legjislative për zhvillimin e aktiviteteve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është Ligji për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Ligji Nr.05/L-042).

Me qëllim të harmonizimit me legjislacionin aktual (me theks në Ligjin për Kundërvajtje) me 20 korrik 2019 ka hy në fuqi Ligji nr. 06/l -088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

2.1. Baza ekzistuese ligjore e cila rregullon funksionimin e ARRU:

- Ligji për rregullimin e shërbimeve të Ujit - Ligji Nr.05/L-042
- Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit – Ligji Nr. 06/l -088

Sipas autorizimeve të dhëna nga kjo bazë ligjore dhe legjislacionit tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit, ARRU përmes akteve nënligjore (Rregulloreve) ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme rregullimin e fushave të veçanta për të cilat ky institucion është përgjegjës.

Në vijim janë listuar Rregulloret e ARRU:

- Rregullore për kartën e konsumatorëve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 03/2016);
- Rregullore për Inspektimin e përmbushjes së obligimeve rregullatore nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr.04/2016);
- Rregullore për licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 05/2016);
- Rregullore për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 06/2016);
- Rregullore për përcaktim të tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 07/2016);
- Rregullore për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve (Nr.09/2019)
- Rregullore për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 10/2019);
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 03/2016, Rregullores nr. 04/2016, Rregullores nr. 05/2016, Rregullores nr. 06/2016 dhe Rregullores nr. 07/2016 (Nr. 11/2019)
- Rregullorja e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare (Nr.01/2016);
- Rregullorja e brendshme për kontrollimin financiar në ARRU (Nr 02-AF/2016);

- Rregulloren Nr. 05-OB/2019 për Ndryshimin dhe Plotësim të Rregullores Nr. 03- OB/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Autoritetin Rregullator për Shërbime të Ujit.

Varësisht nga vlerësimet dhe nevojat e paraqitura nga palët e interesit, Rregulloret mund të rishqyrtohen dhe mund të pësojnë ndryshime.

2.2. Vështirësitë ligjore :

- Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/L -088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, neni 4, paragrafi 2 ka lënë të paqartë faturimin e objekteve të kulteve fetare. Për të sqaruar këtë çështje ARRU i është drejtuar Kuvendit të Kosovës, zyrës ligjore të Kryeministrit dhe së fundmi Avokatit të Popullit. Deri më tani nuk kemi marr asnjë përgjigje.
- Ndryshimit të Ligjit të Prokurimit për institucionet e pavarura me më pak se 50 punëtorë, nuk i kryejnë procedurat e prokurimit në mënyrë vetanake por kryhen nga AQP, ka paraqitur shumë vështirësi për ARRU në ekzekutimin e buxhetit për vitin 2019 për shkak të të cilit kanë mbetur prokurimet të pa realizuara si kursi i gjuhës angleze.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë, i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujës-jellës, kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Kosovë.

3.1. Vizioni/Misioni

Vizioni:

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni:

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

3.2. Kompetencat e ARRU

Bazuar në kornizën ligjore aktuale, si institucion përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesëve të shërbimeve ka kompetenca për:

- Licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit;
- Përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve;
- Vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve;
- Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për të vlerësuar nëse ata i përmbushin kushtet e përcaktuara me licencën e shërbimit, si dhe caqet e përcaktuara me procesin tarifor;
- Shqyrton dhe vendos për ankesat e konsumatorëve të paraqitura kundër vendimeve të ofruesit të shërbimeve.
- Hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr.05/L-042 dhe ligjeve tjera të aplikueshme;
- Inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

Në vijim janë përshkruar përgjegjësitë kryesore të njësive organizative të ARRU, funksionimi i të cilave mundëson përmbushjen e kompetencave të cekura më lart dhe detyrave tjera të përcaktuara me ligj:

Departamenti për çështje ligjore dhe licencim: siguron mbështetjen ligjore. Ky departament gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore përveç që bazohet në ligjet e Republikës së Kosovës, si pikë reference ka edhe direktivat dhe rregulloret e Unionit Evropian. Gjithashtu menaxhon procesin e licencimit të ofruesëve të shërbimeve të ujit, përfshirë edhe vlerësimin në baza të rregullta të përmbushjes së kushteve të licencimit, si dhe propozimin e masave për përmirësim. Departamenti poashtu ka ofruar ndihmë profesionale dhe ka monitoruar punën e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve deri në shuarjen e tyre (korrik 2019) me Ligjin Nr.06/L – 088. Me shuarjen e Komisioneve

Këshilluese të Konsumatorëve në pajtim me nenin 5, të Rregullores Nr. 09/2019 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, në kuadër të këtij departamenti është themeluar Komisioni për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve I cili është organ përfundimtar në procedurën administrative.

Departamenti për tarifa: siguron mbështetje në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit. Ky proces përfshin caktimin e caqeve të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara. Përmes këtij procesi, departamenti siguron gjetjen e bilancit në mes të mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit. Ky departament siguron, në baza të rregullta, vlerësimin e përmbushjes së caqeve dhe propozimin e masave për përmirësim.

Departamenti për raportim të performancës: siguron mbështetje në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve tarifore. Ky departament bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit, në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

Departamenti për administratë dhe financa: siguron mbështetje administrative. Ky departament mbështet udhëheqjen e Autoritetit për një funksionim normal të departamenteve duke menaxhuar burimet njerëzore, buxhetin dhe financat e Autoritetit, aktivitetet ndihmëse, si dhe koordinimin e furnizimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit.

Njësia për inspektim: siguron mbështetje në aktivitetin e inspektimit në përgjithësi dhe raportimin dhe inspektimin e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të ujit në veçanti. Qëllimi i inspektimit është të verifikojë se ofruesit e shërbimeve i kryejnë aktivitetet e tyre në pajtim me legjislacionin aktual. Procesi i inspektimit përfshin grumbullimin, inspektimin në vend-ndodhje, përpunimin e të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT

Fushëveprimi i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit përfshin ndërmarrjet publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë në Kosovë.

Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bërë nga ARRU me datën 25.09.2018, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042, si dhe me procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, në kohëzgjatje prej 8 (tetë) vitesh.

(i) Kompanitë e licencuara për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit):

- **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë;
- **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë Dragash dhe Mamushë;¹
- **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan;
- **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
- **KRU “Gjakova” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe disa fshatra të Prizrenit;
- **KRU “Hidromorava” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
- **KRU “Bifurkacioni” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunën: Ferizaj dhe Kaçanik.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU.

Komunat Shtërpce, Novo Bërdo, Partesh, Kllokot, Ranillug dhe Hani i Elezit planifikohet të integrohen në kompanitë rajonale përkatëse, pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre. Rehabilitimi është planifikuar përmes investimeve të fazës së V-të të projektit të SDC (investim i Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane). Marrëveshjet me komunat përkatëse janë nënshkruar dhe integrimi do të bëhet pas pranimit teknik të punëve.

Në Mitrovicën veriore vazhdon të operojë pa licencë ofruesi i shërbimeve NPK “Vodovod Ibar”. ARRU në vazhdimësi ka bërë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi përmes procedimit të letrave dhe paralajmërimeve siq e autorizon Ligji nr. 05/L-042, neni 4.3.1. Meqenëse nuk kemi pasur asnjë përgjegje

¹ Edhe pse në zonën e shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, për arsye të moskryerjes së obligimeve të të gjitha palëve (mospërmbushjes së obligimeve nga ana e Komunës, mosgadishmërisë së konsumatorëve të kësaj komune për kyçe individuale, mospërfundimit të disa riparimeve teknike nga KRU) edhe gjatë vitit 2019 konsumatorët nuk kanë marrë shërbime të ujësjellësit nga kjo kompani.

pozitive dhe shkresat janë kthyer me arsyetimin e refuzimit të pranimit, në pajtim me Ligjin Nr.05/L-042, ARRU ka inicuar procedurë gjyqësore me datë 30 shtator 2014 - akoma jemi në pritje të vendimit të gjykatës

Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

- **“Ibër-Lepenci” Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.


Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Ujërave të Ndotura



KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KRU-të
Prishtina Podujeva Fushë Kosova Obiliçi Lipjani Drenasi Shtime Graçanica	Prizreni Suhareka Malisheva Dragashi Mamusha	Peja Istogu Klina Juniku Deçani	Mitrovica Skenderaj Vushtrria	Gjakova Rahoveci Prizren (disa fshatra)	Ferizaj Kaçaniku	Gjilani Kamenica Vitia	Novobërda Zubin Potoku Leposaviçi Zveçani Shtërpce, Hani i Elezit, Partesh, Rani llug, Mitrovica e Veriut, Kllokot

4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregulator për shërbimet e ujit

ARRU aktivitetet e veta i përmbush sipas organizimit të paraqitur në organogram



4.2. Bordi

Autoriteti rregullator për shërbime të ujit, sipas Ligjit Nr.05/L-042 nuk ka Bord.

4.3. Ekzekutivi

a) Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU.

Drejtori i ARRU është përgjegjës për: administrimin, menaxhimin dhe organizimin e ARRU, punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative, menaxhimin e resurseve dhe buxhetit të ARRU, përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit si dhe detyrat tjera të përcaktuara me ligjin Nr. 05/L-042.

Zëvendës Drejtori i ARRU: ndihmon drejtorin në kryerjen e detyrave të tij. Në mungesë të drejtorit, ARRU udhëhiqet nga zëvendësdrejtori.

b) Menaxhmenti i mesëm i ARRU

Menaxhmenti i mesëm përbëhet nga kryesuesit/udhëheqësit e njësive organizative të ARRU të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e njësive organizative përkatëse, bashkëpunim me njësitë tjera organizative të ARRU, këshillojnë drejtorin lidhur me temat specifike të njësive organizative përkatëse si dhe detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (Nr. 03-OB/2016) dhe Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës (Nr. 05-OB/2019).

c) Mandati

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar.

- Drejtori është zgjedhur me 28 prill 2016 dhe ka mandat deri me 28 prill 2021,
- Zëvendës Drejtori është zgjedhur me 28 tetor 2016 dhe ka mandat deri me 28 tetor 2021.

4.4. Burimet Njerëzore

a) Numri i përgjithshëm i punëtorëve në ARRU është njëzet e një (21).

b) Gjatë vitit 2019 ARRU ka kompletuar stafin me plotësimin e një pozite të re, si dhe plotësimin e një pozite të zbrazët.

4.5. Asetet

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i thesarit.

Vlera e aseteve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2019 në ARRU është 20,821.00 €.

Asetet mbi 1000€ janë 00.00€ ndërsa asetet nën 1000€ janë 20,821.00 €.

Asetet e ARRU (mbi 1,000 dhe nën 1,000 euro) janë mjetet e punës përmes të cilave i përmbushim obligimet tona. Në këto mjete bëjnë pjesë: vetura (4), (vlera e te cilave është zero ne regjistrat e thesarit pasuritë mbi 1,000 euro të blera në vitin 2005-2006) kompjuterë, laptopë, printerë, fotokopje, server, tavolina, karrige orman etj.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

Përmes aktiviteteve të veta dhe autoritetit të dhënë me ligj, ARRU siguron që ofruesit e licencuar të shërbimeve veprojnë në bazë të legjislacionit aktual. Përbushja e këtyre obligimeve edhe gjatë vitit 2018 është arritur përmes aktiviteteve dhe detyrave të parapara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor të Punës së ARRU.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet, procedurat dhe rezultatet e aktiviteteve të ARRU për periudhën raportuese (vitin 2018). Gjithashtu për ti dhënë lexuesit të këtij Raporti një pasqyrim të përgjithshëm të gjendjes së sektorit të ujit në Kosovë përmes disa treguesve kyç të performancës janë paraqitur rezultatet e ofruesve të shërbimeve në përbushjen e caceve të përcaktuara nga ARRU, si dhe performanca e tyre.

5.1. Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L - 042

Plotësim ndryshimi i Ligjit Nr.05/L-042 është iniciuar për arsye të mospërputhjeve ligjore të cilat janë krijuar me miratimin e Ligjit për kundërvajtje Nr.05/L-087, si dhe shqetësimeve tjera të ngritura nga ofruesit e shërbimeve. Edhe gjatë vitit 2019 me kërkesë të Komisionit, ARRU ka dhënë propozime dhe opinione për amendamentet e ngritura nga palët tjera. Ligji nr. 06/l -088 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit ka hyrë në fuqi me 20 korrik 2019.

5.2. Harmonizimi i akteve nënligjore (Rregulloreve) me Ligjin për plotësim ndryshimin e Ligjit për shërbimet e ujit (Ligji Nr.06/L – 088)

Me hyrjen në fuqi të Ligji Nr.06/L – 088, dhe në pajtueshmëri me legjislacionin tjetër aktual të Republikës së Kosovës, janë nxjerrë si dhe ndryshuar dhe plotësuar Rregulloret e ARRU si në vijim:

- Rregullore për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve (Nr.09/2019) – rregullore e re.
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 03/2016, Rregullores nr. 04/2016, Rregullores nr. 05/2016, Rregullores nr. 06/2016 dhe Rregullores nr. 07/2016 (Nr. 11/2019) – rregullore e re.
- Rregullore për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 10/2019) – rregullore e re, pas shfuqizimit të rregullores së vjetër.
- Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 03-0B/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të punës në Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit (Nr.05-OB/2019) – plotësim ndryshim i rregullores.

5.3 Aprovimi i Planeve të ofruesve të shërbimeve

Bazuar me nenin 6, paragrafi 2.2. dhe nenit 48 të Ligjit nr. 05/L-042, ka pranuar dhe pas shqyrtimit, analizave dhe diskutimeve me ofruesit e shërbimeve ka aprovuar:

- Planet e Biznesit;
- Planet afatgjata të investimeve kapitale.

5.4. Rishikimi i tarifave për vitin 2020

Baza e rishikimit të tarifave për faturim të konsumatorëve të shërbyer janë; shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara gjatë procesit rregullator të tarifave, për vitet përkatëse paraprake dhe vitit aktual; shkalla e realizimit të investimeve kapitale nga burimet e vetëfinancimit të ofruesit të shërbimeve gjatë periudhës së shikuar për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi; shkalla e lëvizjeve të inflacionit dhe gjendja socio-ekonomike në vend.

Lëvizjet e inflacionit shfrytëzohen nga publikimet e bëra të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudha të caktuara të lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë.

Me qëllim të një pasqyre më të qartë të faktorëve të cilët ndikojnë në përcaktimin e tarifave, ARRU ka analizuar në mënyrë më të detajuar dhe ka publikuar raportet:

- Analiza vjetore e shpenzimeve operative të sektorit për 2019;
- Analiza vjetore për investime kapitale dhe asetë.

Inkurajuese nga kjo periudhë e raportimit është se ofruesit e shërbimeve si rezultat i procesit tarifor 2018-2020 dhe i urdhëresave tarifore të shërbimit kanë zvogëluar shpenzimet e operimit, por vazhdon të jetë brengosëse struktura e shpenzimeve, gjë për të cilën janë dhënë rekomandime dhe paralajmërime për refleksionet e kësaj çështjeje tek tarifat dhe performimi i tyre.

Vazhdon gjithashtu të jetë brengosëse pamundësia e faturimit nga ofruesit e shërbimeve për ujin e trajtuar me shumicë në pjesën veriore të Kosovës.

Përmes politikës tarifore dhe sistemit kalkulues, kemi arritur që ofruesit e shërbimeve të operojnë në konsistencë me qëndrueshmëri financiare, duke mos i ngarkuar financiarisht konsumatorët.

Tarifat fikse (€/muaj) për konsumatorët shtëpiakë për shërbimet publike të ujit, kanë mbetur të njëjta, që nga fillimi i përcaktimit të tyre (2005-2006), dhe do të ngarkohen për çdo muaj me nga 1.00 €/muaj, ndërsa konsumatorët jo-shtëpiak duke filluar nga viti 2018 janë ngarkuar me nga 2.00 €/muaj, për dallim prej 3.00€/muaj sa kanë paguar deri në fund të vitit 2017.

Në pasqyrën vijuese tabelore po pasqyrojmë tarifat vëllimore të shërbimeve publike për furnizim me ujë dhe ato të shërbimeve të ujërave të ndotura, të aplikuara gjatë periudhës 2016, 2017, 2018, 2019 dhe tarifat e aplikueshme për vitin 2020, për çdo kompani rajonale dhe tarifat mesatare të sektorit në nivel të vendit.

Tabela nr. 1 Tarifatat përmbledhëse vëllimore për shërbimet e ujit dhe ujërave të ndotura për të dy grupimet e konsumatorëve 2016-2020

Kompania	Grupimi i konsumatorëve	Njësia	Tarifatat e vitit 2016	Tarifatat e vitit 2017	Tarifatat e vitit 2018	Tarifatat e vitit 2019	Tarifatat e vitit 2020
KRU Prishtina	Shtëpiak	€/m ³	0.44	0.44	0.47	0.48	0.48
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.99	0.99	0.96	0.88	0.80
KRU Hidroregjioni	Shtëpiak	€/m ³	0.42	0.42	0.44	0.50	0.46
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.80	0.80	0.82	0.95	0.84
KRU Hidrodrini	Shtëpiak	€/m ³	0.30	0.30	0.32	0.32	0.32
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.61	0.61	0.61	0.60	0.59
KRU Mitrovica	Shtëpiak	€/m ³	0.45	0.45	0.45	0.45	0.45
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.96	0.96	0.91	0.84	0.77
KRU Gjakova	Shtëpiak	€/m ³	0.45	0.45	0.47	0.46	0.44
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.93	0.93	0.9	0.88	0.83
KRU Bifurkacioni	Shtëpiak	€/m ³	0.46	0.46	0.47	0.47	0.47
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.98	0.96	0.89	0.81
KRU Hidromorava	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.41	0.42	0.42	0.42
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.85	0.85	0.86	0.78	0.71
SEKTORI	Shtëpiak	€/m ³	0.42	0.42	0.43	0.44	0.43
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.87	0.87	0.86	0.83	0.76

Në këtë tabelë janë pasqyruar vlerat tarifore (pa TVSH).

Tarifatat e periudhës së rregullt tarifore 2018-2020 janë përcaktuar sipas nivelit të kostove të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, të dhënave të tjera të planifikuara për gjashtëmujorin e dytë të të njëjtit vit, dhe të dhënave të tjera të planifikuara për periudhën 2018-2020.

ARRU në baza të rregullta vjetore merr për analizë krahasimin e tarifave të disa shteteve të rajonit. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur tarifatat volumetrike për shërbimet e ujit dhe të ujërave të ndotura, për konsumatorët shtëpiak dhe ata jo-shtëpiak.

Tabela nr. 02 tarifat volumetrike për shërbimet e ujit dhe ujrave të ndotura, për kons.shtëpiak dhe jo-shtëpiak

Nr	Shteti	Qyteti	Konsumatorët	Tarifa volumetrike për ujë dhe kanalizim €/m ³
1	Kosovë	Mesatarja	Shtëpiak	0.43
			Jo shtëpiak	0.76
2	Shqipëri	Tiranë	Shtëpiak	0.62
			Jo shtëpiak	1.39
2	Shqipëri	Durrës	Shtëpiak	0.98
			Jo shtëpiak	1.48
3	Maqedoni	Shkup	Shtëpiak	0.48
			Jo shtëpiak	1.07
4	Mali i Zi	Herceg Novi	Shtëpiak	0.57
			Jo shtëpiak	1.86
5	Serbi	Novi Sad	Shtëpiak	0.70
			Jo shtëpiak	0.92
6	Bosnja dhe Hercegovina	Sarajevë	Shtëpiak	0.61
			Jo shtëpiak	0.85
7	Kroacia	Osijek	Shtëpiak	1.14
			Jo shtëpiak	1.82

Siç shifet në tabelë, tarifat e konsumatorëve shtëpiak dhe jo-shtëpiak, në sektorin ujit në Kosovë janë më të ulëta në rajon.

5.5. Tarifat për shërbimet e ujit me shumicë

Tarifat për NHE “Iber - Lepenc” me të cilat faturohen KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina llogariten në bazë të largësisë respektivisht gjatësisë së kanalit dhe sasisë së ujit të liferuar. Nga tabela e mëposhtme, mund të vëreni se këto tarifa për KRU Mitrovica dhe për KRU Prishtina gjatë vitit 2020 janë të njëjta me tarifat e vitit 2019 për arsye të procesit trevjeçar 2018-2020.

Për KRU “Mitrovica” sh.a Mitrovicë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shipol të Mitrovicës, dhe për Fabrikën e Përpunimit të Ujit në Balincë të Vushtrrisë.

Për KRU “Prishtina” sh.a Prishtinë, tarifat janë të aplikueshme për Fabrikën e përpunimit të Ujit në Shkabaj të Prishtinës, dhe për Fabrikën e përpunimit të ujit në Drenas.

Tabela nr.03 Tarifat e NHE Ibër - Lepenci e ujit të pa trajtuar me shumicë

Numri rendor	KRU-të	Njësia tarifore	Viti 2019	Viti 2020
1	Mitrovica	€/m ³	0.0163	0.0163
2	Prishtina	€/m ³	0.0364	0.0364

Tarifat e paraqitura në tabelë janë çmimet për njësi, të cilat do ta përbëjnë vlerën faturave (pa TVSH).

5.6 Tarifat për Mitrovicën e Veriut

Baza për llogaritjen e Tarifave të ujit me shumicë të përpunuar, me të cilin KRU “Mitrovica” furnizon pjesën veriore të qytetit, është sasia e ujit të dërguar në pjesën veriore, bashkëngjitur edhe shpenzimet për njësi.

Tarifa për m³ për pjesën veriore është 0.17 €/ m³, tarifë kjo e llogaritur bazuar në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ku janë të ndara kosto qendrat e shërbimeve të ujësjes. Sipas UKRR janë tre kosto qendra: (1) Resurset dhe Trajtimi i Ujit, (2) Distribuimi i ujit dhe (3) Aktivitetet Biznesore. Me anë të kësaj ndarjeje, krijohet mundësia për të pasur një pasqyrë më të qartë të alokimit të shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për të gjitha KRU-të në Kosovë (rasti: KRU “Mitrovica”).

Mbështetur në faktin se KRU “Mitrovica” nuk operon në pjesën veriore të qytetit, uji i distribuuar për atë pjesë nga Fabrika e Përpunimit të Ujit në Shipol, përmes gypave nga pjesa jugore e qytetit, nga katër dalje i dërgohet pjesës veriore. Rrjedhimisht nga kjo nënkuptohet se për të dërguar këtë sasi të ujit gjenerohen shpenzime të konsiderueshme në Resurse, Trajtim dhe Aktivitete Biznesore e më pak në kosto qendrën Distribuim.

Analizat e bëra rezultojnë se për furnizimin me ujë të pjesës veriore krijohen 47 % të shpenzimeve totale operative në Resurse, Trajtim (fabrika e ujit) dhe Aktivitete Biznesore (shpenzimet e administratës), si dhe 15% të shpenzimeve totale të distribuimit.

Pra, shpenzimet totale që gjeneron KRU “Mitrovica”, alokimi i mësipërm i shpenzimeve operative në raport me sasinë e ujit të dërguar për pjesën veriore të qytetit, përbëjnë bazën e kalkulimit të tarifës në €/m³.

Tabela nr. 4 Tarifat dhe faturimi në € dhe m³ për pjesën veriore të Mitrovicës

Emërtimi	Njësia	2016	2017	2018	2019
Faturimi në m ³	m3/vit	4,443,322	4,857,468	5,620,207	6,093,935
Tarifa e ujit të trajtuar me shumicë	€/m3	0.170	0.170	0.170	0.170
Faturimi në €	€/vit	755,365	825,770	955,435	1,035,969

Theksojmë se procesi i përcaktimit të Tarifave për ujin me shumicë të përpunuar, për pjesën veriore, është proces i ndarë nga procesi i përcaktimit të tarifave të ujit për konsumatorët e Regjionit të Mitrovicës, për shkak të çmimit të ndryshëm (uji me shumicë). Konsumatorët e pjesës jugore nuk paguajnë faturat për pjesën veriore, apo thënë ndryshe nuk janë ngarkuar me tarifa më të larta, si pasojë e mospagesës nga qytetarët e pjesës veriore.

Faturat për pjesën veriore nuk i pranon askush edhe pse me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit për Ujin me shumicë të përpunuar, theksohet se KRU Mitrovica duhet të lidhë kontratë me autoritetet e pjesës veriore për furnizim me ujë të pijshëm me shumicë, mbështetur mbi parimin: Konsumatori Pagan.

5.7. Politikat tarifore

Tarifat e Shërbimit për furnizim me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura dhe të furnizimit të ujit me shumicë, nuk duhet që të jenë diskriminuese, përveç nëse ndryshe vendoset nga Autoriteti. Ofruesit e shërbimeve duhet të përdorin tarifën e njëjta të shërbimit në Zonat e tyre të Shërbimit.

Tarifat për shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë duhet të përcaktohen në bazë të kostove aktuale të furnizimit tek secili Ofrues i Shërbimeve të Ujësjetës dhe Ujërave të ndotura;

- Tarifat duhet të përcaktohen në bazë të asaj që rrjedha e të hyrave që ato i gjenerojnë të jenë të mjaftueshme për të financuar aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve, në përputhshmëri me kërkesat e tyre ligjore dhe Rregullatore, që përkufizohet: si kërkesë e të hyrave e cila hyn në raport me sasinë e ujit të shitur dhe arkëtimin, e që mund të ndryshohet me politikën e veçanta tarifore.

5.8. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave)

Përmes këtij aktiviteti është monitoruar përmbushja e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ARRU përmes procesit tarifor. Përmbushja apo mospërmbushja e këtyre caqeve është një ndër faktorët përcaktues për përcaktimin e tarifave të vitit pasues.

Procedurat e monitorimit kryhen nga analizimi i të dhënave për përmbushje apo mospërmbushje të caqeve të aprovuara, të treguesve kryesor, të cilët janë të njëjtë për analizimin e të gjitha kompanive.

Të dhënat sigurohen nga raportimet në baza mujore dhe raportet vjetore të ofruesve të shërbimeve, të cilat si plotësisht të vlefshme llogariten pasi të ketë përfunduar procesi i analizimit dhe auditimit nga stafi profesional i ARRU.

Pasqyra e plotë e afarizmit të të gjithë ofruesve të shërbimeve dhe sektorit do të dihen me finalizimin e pasqyrave financiare të vitit 2019, të cilat duhet të kompletohen deri në fund të Marsit të vitit 2020.

Të dhënat janë paraqitur në formë tabelore në të cilën janë pasqyruar të dhënat e vitit 2018 (për krahasim), të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2019, të dhënat e realizuara gjatë vitit 2019, përqindja e përmbushjes/mospërmbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtar.

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përmbushjes së caqeve për vitin 2019 janë të dhëna të pa audituara (meqenëse pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur) ndërsa të dhënat e vitit 2018 janë të verifikuara me procesin e auditimit. Të dhënat e vitit 2019 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.

Në vijim të raportit, përmes tabelave dhe shpjegimeve është paraqitur shkalla e përmbushjes së caqeve të aprovuara nga ARRU të disa prej treguesve kryesor në nivel të sektorit nga ana e ofruesve të shërbimeve gjatë vitit 2018. Për të dhëna të plota mund të shikoni: <http://www.arru-rks.org>. Tarifat, Raportet, Raport mbi Vlerësimin e Përmbushjes së Caqeve për periudha të caktuara të vitit 2018 nga procesi rregullator i tarifave të periudhës 2015-2017.

5.8.1 Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve

Për analizën e të dhënave operative kemi marrë parasysh të dhënat sasiore për metër kub (m³) për: (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (IV) ujërat e ndotura të faturuara; (V) numri i konsumatorëve.

Tabela nr. 5 Të dhënat për ujin e prodhuar , të humbur, faturuar dhe numrin e konsumatorëve

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia matëse	Historiku i realizuar 2018	Aprovuar për vitin 2019	Realizuar për vitin 2019	% e realizuar 2019
a	b	c	d	e	f =(e/d)
Uji i prodhuar	m ³	157,761,608	139,663,111	152,877,087	109%
Uji i humbur	m ³	91,526,261	68,360,040	84,813,113	124%
Uji i faturuar	m ³	66,235,347	71,303,072	68,063,974	95%
Konsumatorët	nr	355,030	342,170	376,614	110%

Të dhënat sektoriale të lartë cekura pasqyrojnë shkallën e realizimit dhe mos realizimit të objektivave për grupimin e parë tek katër treguesit bazik për vitin fiskal 2019.

Kur shikohen të dhënat sektoriale mund të konstatohet se sasia e ujit të humbur dhe ajo e faturuar nuk janë realizuar dhe performanca e tyre vlerësohet negativisht, ndërsa sasia e ujit të prodhuar edhe pse në shikim të parë është e realizuar del të jetë negative, për shkak të humbjeve të shtuara të ujit dhe mos faturimit të sasisë së ujit të aprovuara me BPRR-ën për periudhën e shikuar. Sa I përket numrit të konsumatorëve plani është tejkaluar për 10%.

5.8.2. Përbushja e caqeve për shpenzimet operative

Në formë tabelare (tabela Nr. 6) janë paraqitur të dhënat sektoriale për shpenzimet operative, duke paraqitur kostot paraprake të shërbimeve të ujit për vitin 2018 dhe ato të aprovuara dhe realizuar gjatë vitit 2019, të cilat na mundësojnë krahasimin e këtyre të dhënave dhe vlerësimin e shkallës së përbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2018.

Tabela nr. 6 Të dhënat e shpenzimeve operative

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Valuta	Historike 2018	Aprovuara nga ARRU 2019	Realizuara nga KRU 2019	% e realizuar 2019
a	b	c	d	e	f =(e/d)
Shpenzimet operative për ujë	€	24,030,767	23,972,295	25,654,563	107%
Shpenzimet operative për ujëra të ndotura	€	1,735,835	2,068,046	2,015,164	97%
Gjithsej	€	25,766,601	26,040,341	27,669,727	106%

5.8.3. Përbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim për vitin 2018 dhe ato të aprovuara dhe realizuara nga sektori për vitin 2019, me % dhe vlerësimin për këto të dhëna.

Tabela nr. 07 Të dhënat për faturimin dhe arkëtimin

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Valuta	Historike 2018	Aprovuara nga ARRU 2019	Realizuara nga KRU 2019	% e realizimit 2019
a	b	c	d	e	f=(e/d)
Shuma e faturimit	€	34,169,121	38,453,614	35,255,594	92%
Shuma e arkëtimit	€	31,226,999	34,727,850	32,797,234	94%

Edhe pse kemi rritje të faturimit dhe arkëtimit në euro, gjatë vitit 2019 krahasuar me vitin 2018 KRU-të nuk kanë arritur të realizojnë caqet e përcaktuara dhe të aprovuara nga ARRU për vitin 2019.

5.8.4. Përbushja e caqeve të investimeve kapitale

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për investimet kapitale për vitin 2018 dhe ato të aprovuara dhe realizuara nga sektori për vitin 2019, me % dhe vlerësimin për këto të dhëna.

Tabela nr. 08 të dhënat sektoriale për investimet kapitale

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Valuta	Historike 2018	Aprovuara nga ARRU 2019	Realizuara nga KRU 2019	% e realizimit 2019
a	b	c	d	e	f=(e/d)
Invetimet vetanake	€	7,235,354	3,713,500	1,869,806	50%
Investimet nga donatorët	€	15,505,654	27,653,711	635,812	2.30%

5.9. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit

Përmes këtij aktiviteti ARRU monitoron performancën e ofruesve të shërbimeve në përbushjen e përgjegjësive të tyre dhe përcillet progresi nga viti në vit i përmirësimit të shërbimeve. Ky aktivitet gjithashtu shërben për nxitjen e konkurrencës (benchmarking) mes ofruesve të shërbimeve.

Arritjet maten në bazë të treguesve kyç të performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin.

Performanca matet kundrejt mesatares së sektorit, performancës individuale të secilës kompani, si dhe krahasimit të performancës në vitin 2019 në raport me vitin 2018.

Ky aktivitet në vete përmban organizimin e raportimit të të dhënave nga/për KRU, vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave, vlerësimin e performancës së KRU, si dhe raportimin. Në këtë drejtim janë mbledhur të dhëna nga ofruesit e shërbimeve në baza tre mujore dhe vjetore.

Në bazë të këtyre të dhënave, ARRU me qëllim të informimit të të gjitha palëve të interesit ka publikuar Raportin Vjetor të Performancës për vitin 2018 për kompanitë të cilat ofrojnë shërbime të ujit, si dhe ka përgatitur raporte tjera periodike siq janë: Përpilimi i raportit gjashtëmujor 2019H1 për performancën e KRU, përpilimi i raportit “Analiza e gjendjes së ujit të pa faturuar në Kosovë”, si dhe përpilimi i udhëzuesit për Modelin e Balancit të ujit.

Janë përpiluar 2 (dy) formate të raportimit për ofruesit e shërbimeve: Raporti tre (3) Mujor dhe Raporti Vjetor. Përmes sistemit të raportimit tre mujor grumbullohen të dhënat financiare, operative dhe shërbimi ndaj konsumatorëve, si dhe plani i monitorimit vjetor (PMV) i cili parasheh raportimin vjetor sipas konceptit rregullator, si dhe është përpiluar Udhëzuesi dhe moduli për përcaktimin/vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga KRU.

Sipas raportimeve të kërkuara është përditësuar në baza të rregullta edhe baza e të dhënave e ARRU-së, e cila përbëhet nga dy programe softuerike ROFK dhe DB vjetore. Të dy programet mundësojnë procedimin e treguesve të performancës në mënyrë automatike, si dhe ofrojnë mundësinë e gjenerimit të raporteve në forma dhe periudha kohore të ndryshme, varësisht nga kërkesat e caktuara.

Bazuar në këto të dhëna pas analizave, si dhe verifikimit të tyre përmes procesit të auditimit, si çdo vit edhe në vitin 2019 ARRU ka publikuar Raportin Vjetor të Performancës (për vitin 2018) në të cilin pasqyrohet performanca e përgjithshme e sektorit dhe e ofruesve të shërbimeve veç e veç.

Në vijim, për informimin e lexuesit të këtij raporti, përmes disa prej treguesve kyç të performancës (TKP) është paraqitur performanca e përgjithshme e sektorit dhe performanca individuale për shtatë ofruesit e shërbimeve, të cilët janë të licencuar nga ARRU. Me qëllim të paraqitjes së krahasimit të zhvillimit në nivel të sektorit janë paraqitur të dhënat e këtyre treguesve në periudhë pesë (5) vjeçare, ndërsa performanca individuale është paraqitur përmes krahasimit të zhvillimit në vitin 2019 në raport me vitin 2018.

Theksojmë se të dhënat e paraqitura për vitin 2019, janë të dhëna të pa audituara, pasi pasqyrat financiare të ofruesve të shërbimeve ende nuk janë përmbyllur, ndërsa të dhënat për vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018 janë të dhëna të audituara nga ARRU.

5.9.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Ky tregues paraqet përqindjen e popullatës e cila ka qasje në shërbime të ujit në sistemet të cilat menaxhohen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së tyre të shërbimit (zonë për të cilën ofruesit janë licencuar nga ARRU). Kjo përqindje nuk e përfshin popullatën e cila është jashtë zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar nga ARRU.

Vlerësimi i mbulimit me shërbimet të ujit është bazuar në regjistrimin e popullatës nga ASK në vitin 2011, duke marrë parasysh edhe koeficientin e parashikimit të trendit (shtimit/zvogëlimit) të popullatës dhe popullatës të cilët kanë qasje në sistemet publike të ujit, të cilat menaxhohen nga ofruesit e licencuar të shërbimeve brenda zonës së tyre të shërbimit.

Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit: Popullata e përgjithshme në zonat e shërbimit për të cilat janë të licencuar ofruesit e shërbimeve vlerësohet të jetë 1,790,094 banorë, prej të cilëve qasje në shërbime të ujësjellësit nga ofruesit e licencuar kanë 1,338,364 banorë, apo shprehur në përqindje 75%.

Në tabelën e mëposhtëm është paraqitur mbulueshmëria e popullatës me qasje në shërbime të ujësjellësit në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve.

Tabela nr. 09 mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Ofruesi i shërbimeve	Total popullata në zonën e shërbimit	Popullata me shërbime të ujësjellësit nga KRU	Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit ne 2019
Hidromorava	182,926	107,819	59%
Hidroregjioni Jugor	329,688	207,967	63%
Mitrovica	200,085	141,070	71%
Bifurkacioni	153,200	115,580	75%
Hidrodrini	229,938	188,215	82%
Prishtina	520,545	420,559	81%
Gjakova	173,712	157,154	90%
Sektori	1,790,094	1,338,364	75%

Mbulueshmëria me shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura: Popullata e përgjithshme në zonat e shërbimit për të cilat janë të licencuar ofruesit e shërbimeve vlerësohet të jetë 1,790,094 banorë, prej të cilëve qasje në shërbimet e grumbullimit të ujërave të ndotura nga ofruesit e licencuar kanë 1,160,520 banorë, apo shprehur në përqindje 65%.

Në tabelën e mëposhtëm është paraqitur mbulueshmëria e popullatës me qasje në shërbime të grumbullimit të ujërave të ndotura në raport me popullatën e përgjithshme brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve.

Tabela nr. 10 mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të ndotura

Ofruesi i shërbimeve	Total popullata në zonën e shërbimit	Popullata me shërbime të ujërave të ndotura nga KRU	Mbulueshmëria me shërbimet e ujërave të ndotura ne 2019
Hidrodrini	229,938	104,601	45%
Hidromorava	182,926	92,461	51%
Mitrovica	200,085	119,696	60%
Hidroregjioni Jugor	329,688	204,735	62%
Gjakova	173,712	117,000	67%
Bifurkacioni	153,200	113,620	74%
Prishtina	520,545	408,406	78%
Sektori	1,790,094	1,160,520	65%

Theksojmë edhe një herë se kjo përqindje nuk do të thotë se pjesa tjetër e popullatës brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar nuk kanë qasje në ujë dhe kanalizim - kjo do të thotë se janë jashtë menaxhimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve (sistemet rurale dhe individuale të cilat vetëmenaxhohen nga komuniteti/individit).

5.9.2. Prodhimi i ujit, shitjet dhe uji pa faturuar

Në fig.2, janë paraqitur vlerat sasiore të prodhimit të ujit në raport me shitjet dhe me humbjet e ujit për periudhën 2015-2019.




Fig.2. Vlerat sasiore të prodhimit, faturimit dhe UPF


Në total sasia e ujit të prodhuar dhe distribuuar tek konsumatorët në vitin 2019 është rreth 153 mil.m³. Kjo vlerë e prodhimit është zvogëluar për 3% (4.9 mil.m³) në raport me vitin paraprak 2018.

Shitjet vëllimore të ujit kanë shënuar rritje për rreth 1.8 mil.m³ në raport me vitin paraprak 2018. Aktualisht vlera sasiore e shitjeve është 68 mil.m³.

Uji i Pa Faturuar vazhdon të mbetet një sfidë serioze për të gjitha KRU dhe zvogëlimi i UPF aktualisht është prioriteti më i lartë për sektorin e ujit në Kosovë. Të gjitha KRU kanë hartuar planet strategjike pesëvjeçare (2018–2022) për zvogëlimin e UPF dhe janë duke zbatuar planet individuale të veprimit, proces ky i cili është duke u monitoruar nga ARRU dhe Grupi ndërinstitucional në kuadër të Qeverisë (KNMU).

Uji i pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet) - ndryshe i quajtur si “humbje e ujit”. UPF nënkupton ujin i cili nuk sjell të ardhura për kompanitë, përderisa prodhimi dhe shpërndarja e tij krijojnë shpenzime. Niveli i lartë i UPF ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit.

Në diagramin e mëposhtëm është paraqitur performanca individuale e ujit të pafaturuar për secilin ofrues të shërbimeve për vitin 2019 (e krahasuar me vitin 2018).



Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 11 është paraqitur niveli i ujit të pafaturuar në disa shtetet të rajonit. Të dhënat e kësaj table janë marrë nga databaza e IBNET

Tabela nr. 11 UPF në vendet e rajonit (%)²

Shteti	Viti	UPF(%)
Kosova	2018	58%
Shqipëria ³	2018	63%
Maqedonia	2016	61%
Mali I zi	2016	78%
Bosna e Hercegovina	2018	47%
Serbia	2017	41%
Bullgaria	2016	61%

5.9.3. Efiçienca e faturimit dhe arkëtimit

Tab. 12, në vijim paraqet performancën e shitjeve në nivel të sektorit gjatë 5 viteve.

Tab. 12, Vlera monetare në euro dhe normat për qarkullimin, arkëtimin e keshit

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2015	31,657,596	23,620,484	75%
2016	33,316,638	28,888,522	87%
2017	35,244,735	29,817,012	85%
2018	35,308,926	32,366,803	92%
2019	36,705,722	34,208,628	93%

Gjatë kësaj periudhe vlerësuese 5 vjeçare, shohim një pasqyrë më të qartë të trendit të përmirësimit të bazës financiare të KRU. Kompanitë kanë qenë më azhure në arkëtimin e keshit dhe kjo ka ndikuar që ato të kenë një situatë më të volitshme financiare.

Efiçienca e qarkullimit⁴ përfshinë të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura, subvencionin, si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative. Efiçienca e arkëtimit⁵ (keshit) përfshinë arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura, subvencionin, si dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative.

² Burimi i informacionit-https://database.ib-net.org/search_countries


³ Burimi i informacionit: Raporti I Performancës së ERRU 2018

⁴Efiçienca e qarkullimit e paraqitur në këtë raport dallon nga ajo e paraqitur në Raportin e Performancës, për shkakun se qarkullimi këtu përveç faturimit të rregullt dhe të hyrave tjera operative përfshinë edhe subvencionin, e cila njëkohësisht nuk është e rregulluar për normën e inflacionit.

⁵Efiçienca e arkëtimit e paraqitur në këtë raport dallon ajo e paraqitur në Raportin e Performancës me të njëjtën arsye sikurse të Efiçienca e qarkullimit.

5.9.3.1 Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit është njëri prej treguesve i cili krahas efijencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve. Në vijim është paraqitur performanca individuale e ofruesve të shërbimit, sa i përket shkallës së arkëtimit duke krahasuar vitin 2019 me vitin 2018.



Në 2019 efijenca e arkëtimit është përmirësuar ndjeshëm. Niveli aktual prej 93% është për 2% më tepër se sa në vitin 2018.

5.9.4. Kualiteti i Ujit

Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm bëhet në bazë të UA 16/2012 nga IKSHPK, i cili është institut me përgjegjësinë ligjore për të bërë kontrollin dhe monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm. Niveli i pajtueshmërisë merr parasysh numrin e mostrave të kryera dhe përqindjen e rezultateve që plotësojnë standardin e cilësisë së ujit të distribuuar nga KRU-të. Në këtë raport vlerësimi i kualitetit të ujit është bërë në bazë të të dhënave të raportuara nga IKSHPK në ARRU.

Janë dy llojet e parametrave të marrë në konsideratë: aspekti bakteriologjik dhe fizio-kimike. Gjithësejt për tu testuar në vitin 2019, janë marrë 9,229 mostra të ujit nga rubinetet e konsumatorëve dhe nga to 98.8% i kanë përmbushur standardet e cilësisë. Në aspektin bakteriologjik janë testuar me tepër mostra, gjithsejtë 6,238 sish ku prej tyre 99.2% e tyre, kane qenë në përputhje me vlerat parametrike të lejuara dhe aspektin e cilësisë fiziko-kimike, janë testuar 2,991 mostra nga të cilat 97.9% rezultuan të jenë në përputhje me vlerat e lejuara.

Një përmbledhje e statistikave (normave) të cilësisë së ujit të furnizuar në 2019, sipas KRU dhe në nivel të sektorit është dhënë në tabelën e mëposhtme.

Tab.13, Norma (%) e testeve bakteriologjike dhe fiziko-kimike në përputhje me standardet e cilësisë së ujit sipas KRU-2019

Kompanitë	KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU-Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Mesatare e sektorit
Mikrobiologjike	100.0%	100.0%	99.3%	99.5%	100.0%	95.5%	96.9%	99.2%
Fiziko-Kimike	99.8%	100.0%	100.0%	97.6%	100.0%	91.7%	92.1%	97.9%
Mesatarja për KRU	99.9%	100.0%	99.5%	99.1%	100.0%	94.5%	94.9%	98.8%

5.9.5. Matja e ujit

Matja e ujit të konsumuar është një prej standardeve të rëndësishme të shërbimit të ujit me qëllim të faturimit të konsumatorëve në bazë të konsumit real, si dhe shërben për kontrollin e konsumit dhe humbjeve të ujit.




Fig.4. Proporcioni i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Raporti i matjes për konsumatorët shtëpiak ka shënuar përmirësim nga 95% në 2018 në 96% në 2019.

Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 14 është paraqitur proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në disa shtete të rajonit. Të dhënat e kësaj table janë marrë nga databaza e IBNET.

Tabela nr. 14, Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%) në vendet e regjionit ⁶

Vendet e rajonit	2016	2018
Shqipëria ⁷	65%	74%
Maqedonia	94%	-
Mali i Zi	78%	-
Bosnja e Hercegovina	94%	92%
Serbia	95%	97%
Bulgaria	98%	-
Kosova	93%	95%

5.9.6. Efikasiteti i stafit

Tregon numrin e punonjësve të angazhuar në shërbime të ujësjellësit dhe të ujërave të ndotura për të ju shërbyer 1000 konsumatorëve. Vlerat më të ulëta tregojnë efikasitet më të madhe të stafit në KRU.

Në vijim është paraqitur efikasiteti i stafit për secilin ofrues të shërbimeve dhe mesatarja e sektorit për vitin 2019.




Fig. 5, Efikasiteti i stafit

Edhe pse nuk ka një standard të përcaktuar për numrin e të punësuarve për 1000 konsumatorë, bazuar në praktikat ndërkombëtare rekomandohet 5 punëtor për 1000 konsumator për të pasur efikasitet të mirë të stafit.

5.9.7. Investimet kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura

Investimet në sektorin e shërbimeve të ujit viteve të fundit janë bërë me mjete të siguruara nga KRU, Qeveria e Kosovës, por në një masë të madhe edhe nga donacionet e ndryshme ndërkombëtare që janë në përkrahje të sektorit. Këto investime kanë pasur për synim: përmirësimin në besueshmërinë e furnizimit,

⁶ Burimi i informacionit-https://database.ib-net.org/search_countries

⁷ Burimi i informacionit: Raporti i Performancës së ERRU 2018

cilësinë e ujit, si dhe zgjerimin dhe përmirësimin e infrastructures, që nënkupton se janë rritur kapacitetet prodhuese të ujit, zgjerimin, mirëmbajtjen dhe përrirjen e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shumatat e realizuara të investimeve për gjatë viteve 2015-2019.

Tab. 15. Vlera në Euro e investimeve të realizuara

Viti	Vlera (€)
2015	5.9mil. €
2016	12.8mil. €
2017	55.8 mil. €
2018	25.3 mil. €
2019	2.5 mil. €

Për vitin 2019 investimet e përgjithshme kapitale në nivel të sektorit janë 2.5.mil. €. Nga kjo shumë 75% janë mjetet vetanake të KRU. Nga këto mjete 2.4 mil. €, janë investuar në shërbimin e ujësjellësit dhe pjesa prej 35 mijë €, në shërbimin e ujërave të ndotura.

Aktualisht janë në zhvillim e sipër edhe disa investime të rëndësishme në ngritjen e infrastrukturës dhe Impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura në Regjionet: Prizren, Gjakovë dhe Pejë.

5.9.8 Performanca e NHE-Ibër Lepenci

ARRU është përgjegjëse për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Ibër Lepenci', vetëm për pjesën e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina'.

Në tabelën në vijim janë disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2019 në raport me vitin 2018

Tab. 16. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenci'

Të dhënat statistikore për 2019 / 2018	2018	2019
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m ³)	44,548,630	48,917,200
Faturimi për ujin me shumicë (€)	1,052,904	1,210,418
Arkëtimi për ujin me shumicë (€)	1,204,344	1,236,702
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	1,286,328	1,359,273
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	69	69

Në vitin 2019 siç edhe vërehet nga tabela me lartë, shitjet e ujit në vlerë sasiore për KRU "Mitrovica" dhe KRU "Prishtina" janë ngritur në nivelin prej 4.4 mil. m³ ose 10% në raport me vitin 2018, e cila rritje pastaj ka ndikuar që edhe shitjet e ujit në vlerë monetare të rritjen për 15%.

Po ashtu, janë rritur edhe shpenzimet për furnizimin e ujit me shumicë në nivelin prej 6%.

5.10. Inspektimi i zbatimit të standardeve të shërbimit dhe legjislacionit aktual

Përmes aktiviteteve të inspektimit është përcjellë zbatimi i legjislacionit aktual, standardeve të shërbimit, përpunueshmërisë me kushtet e licencës, zbatimi i rekomandimeve për përmirësim të dala nga inspektimet e vitit 2018, zbatimi i akteve tjera të nxjerra nga ARRU si dhe janë zhvilluar inspektime at-hok bazuar në kërkesat e palëve tjera apo situatave të krijuara.

Në vazhdim të këtij kapitulli janë të paraqitur më detalisht disa prej standardeve të shërbimit të cilat përmes inspektimeve janë përcjellë gjatë vitit 2019, veprimet e ndërmarra nga ARRU dhe rezultatet e arritura nga këto aktivitete.

5.10.1. Inspektimi lidhur me verifikimin e zbatimit e “Vendimit për aprovimin e faturimit të konsumatorëve në rastet pa ujëmatës” (dt.02.03.2018) dhe nenit 14 të Rregullores Nr.08/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.02/2016 për standardet minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë - eliminimi i faturimit pa matje

Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Mbrojtje të konsumatorëve (Nr. 06/L-034) dhe eliminimit të faturimit paushall, ARRU ka nxjerrë Vendim për eliminimin e faturimit pa matje si dhe ka plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren për Standardet Minimale të Shërbimeve. Me këtë rast janë dhënë afate kohore me qëllim që ofruesit e shërbimeve të kenë mundësi zbatimin e tyre. Të përmbledhura hapat e ndërmarrë nga ARRU janë si në vijim:

- Nga muaji Mars 2018 është ndaluar faturimi pa matje për të gjitha kategoritë e konsumatorëve, përveç për konsumatorët e kategorisë amvisëri në banesat kolektive.
- Nga muaji Tetor 2018 është ndaluar faturimi pa matje për të gjitha kategoritë e konsumatorëve.
- Nga muaji Qershor 2019 ARRU ka obliguar KRU-të që konsumatorët e kategorisë amvisëri në ndërtesat e banimit kolektiv deri në vendosjen e ujëmatësve të përbashkët nga ofruesit e shërbimeve, të faturohen vetëm me taksë fikse, ndërsa të gjitha kategoritë tjera që refuzojnë të vendosin ujëmatës të ndërpriten nga shërbimet e ujësjellësit.

Me përmbushjen e afateve të dhëna sipas Vendimit të ARRU dhe Rregullores Nr.08/2018, në fund të vitit 2018 janë iniciuar inspektime tek shtatë ofruesit e shërbimeve me qëllim të verifikimit të zbatimit të këtyre akteve. Gjatë këtij inspektimi është gjetur se asnjëra nga KRU-të nuk i ka plotësuar obligimet e dala nga këto dy akte dhe faturimi i shërbimeve të ujit pa matje ka vazhduar edhe në vitin 2019. Në qershor të vitit 2019, bazuar në inspektimet e zhvilluara nga ARRU numri i përgjithshëm i konsumatorëve pa matje për tërë zonën e shërbimit ka qenë 13,728 konsumatorë. Gjatë gjithë vitit 2019 janë ndërmarrë hapa me qëllim të eliminimit të faturimit pa matje (janë mbajtur takime, janë zhvilluar inspektime, janë nxjerrë paralajmërime si dhe u është dhënë afat kohor KRU-ve për përmbushjen e këtij standardi të shërbimeve).

Si rezultat i hapave të ndërmarrë nga ARRU, nga gjithsej 13728 konsumatorë të faturoar pa matje (te gjetur në Qershor 2019), në dhjetor të vitit 2019 kanë mbetur gjithsej 7533 konsumatorë të cilët faturohen pa matje – shprehur në përqindje ka pasur përmirësim për 54%. Vlen të theksohet se kanë mbetur edhe dy ofrues të shërbimeve (KRU “Prishtina” e cila ka afat deri në Mars 2020 dhe KRU “Mitrovica” e cila ka afat deri në Maj 2020 për të eliminuar faturimin pa matje, përderisa KRU-të tjera e kanë eliminuar në përgjithësi, apo u ka mbetur një numër i vogël i konsumatorëve (kryesisht rastet e konsumatorëve tek të cilët nuk kanë pasur qasje - të cilët nuk jetojnë në Kosovë).

Duke qenë se KRU “Hidromorava” edhe përkundër vendimit të ARRU që “*deri në vendosjen e ujëmatësve të përbashkët konsumatorët e ndërtesave kolektive të faturohen vetëm me taksë fikse*” ka vazhduar të njëjtit të i faturojë me ngarkesë pa matje. ARRU e ka obliguar KRU-në që konsumatorët të kompensohen

(përmes fshirjes së borxhit apo në formë parapagimi). Nga ky aktivitet janë kompensuar gjithsej 1,287 konsumatorë në shumën e përgjithshme prej 32, 427.95 euro. Ky aktivitet do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2020.

5.10.2. Inspektimi i përmbushjes e standardeve të shërbimit dhe kushteve tjera të Licencës.

Me qëllim të inspektimit të rregullt dhe avancimit të përmbushjes së standardeve dhe kushteve tjera të Licencës, projekti mbështetës i ARRU në bashkëpunim me ARRU ka përpiluar “Modulin për përmbushjen e standardeve dhe kushteve tjera të Licencës”, modul ky i cili do të ndihmojë ARRU dhe KRU-të për kontrollimin efikas të rregullt në bazë vjetore dhe planifikim. Me qëllim të verifikimit të nivelit të përmbushjes së standardeve të shërbimit, dhe plotësimin e kushteve të licencës për vitin 2019 në udhëheqje të projektit mbështetës, janë zhvilluar inspektime tek shtatë ofruesit e shërbimeve. Bazuar në të gjeturat e inspektuarës është plotësuar “Moduli për përmbushjen e standardeve dhe kushteve tjera të Licencës” dhe është përpiluar “Raporti mbi përpuethshmërinë me kushtet e licencës – niveli i shërbimeve të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve”. Duke qenë se Raporti përmban rekomandime, i njëjti përveç që do të i shërbejë ofruesve të shërbimeve për të pasur të dhënat e grumbulluara në një databazë, do të i shërbejë ARRU-së që të përcjellë vit pas viti avancimin e ofruesve të shërbimeve në përmbushjen e standardeve të shërbimit dhe kushteve tjera të licencës, si dhe do të jetë bazë për verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të vitit paraprak.

Bazuar në të gjeturat gjatë inspektimit dhe të dhënat e dala nga Raporti, me qëllim të përmirësimit të nivelit të shërbimeve dhe mënyrës së mbajtjes së shënimeve nga ofruesit e shërbimeve, janë mbajtur tri punëtori për përfaqësuesit e ofruesit e shërbimeve me temat:

- Zhvillimi I burimeve njerëzore
- Zhvillimi I relacionit me konsumatorë
- Avancimi I sistemeve monitoruese në KRU – përdorimi i sistemeve SCADA

5.10.3. Inspektimet tematike (At-hok) dhe sipas kërkesave

Bazuar në kërkesat nga palët tjera dhe situatat e krijuara, ARRU ka zhvilluar inspektime at-hok me qëllim të verifikimit të situatës dhe zgjidhjes së problemeve të krijuara përmes rekomandimeve të dhëna.

- **Ujëmatësi në FPU “Perlepnice”** – me kërkesë të KRU “Hidromorava” është zhvilluar inspektim për verifikimin e Ujëmatësit të Prodhimit në FPU “Perlepnice”. Për arsye të thatësisë dhe vendosjes joadekuate të ujëmatësit është vërtetuar se matja e ujit të prodhuar nga ky ujëmatës nuk ka qenë e saktë. Përmes Raportit të inspektimit është dhënë afati kohor dhe rekomandimet për zhvendosjen e këtij ujëmatësi. Aktualisht ky ujëmatës është vendosur sipas rekomandimeve të dhëna dhe është funksional.
- **Kualiteti I ujit ne Nj.O. Kamenice** – me kërkesë të pranuar nga përfaqësuesit e Komunës së Kamenicës për arsye të dyshimeve për kualitet të ujit, është zhvilluar inspektim në pikën e trajtimit , në pikën e marrjes së ujit si dhe në pikën e dyshuar për ndotjen e ujit. Duke qenë se është gjetur ndotësi, institucionet tjera përgjegjëse (Inspektoriati komunal, inspektoriati I MMPH, KRU “Hidromorava”, KNMU dhe IKSHPK) kane vazhduar ndërmarrjen e hapave të mëtejshme bazuar në përgjegjësitë e veta institucionale. ARRU ka vazhduar të jetë pjesëmarrëse aktive në të gjitha takimet dhe iniciativat nga institucionet përgjegjëse deri në riaktivizimin e kësaj pike te trajtimit të ujit.

- **Furnizimi me uje I Mamushës** - me kërkesë të KRU "Hidroregjioni" dhe KNMU është zhvilluar inspektim në sistemin e ujësjellësit në Mamushë me qëllim të identifikimit të problemeve të cilat ka kjo Komunë rreth furnizimit me ujë të pijes. Bazuar në rekomandimet e Raportit të inspektimit, KRU "Hidroregjioni Jugor" ka ndërmarrë masa në rregullimin e dëmtimeve të rrjetit të ujësjellësit, në pastrimin dhe rifunksionalizimin e rezervoarit kryesor si dhe ka siguruar sasinë e mjaftueshme të sasisë së kërkuar të ujit për këtë komunë. Edhe përkundër këtyre masave për shkak të mosgadishmërisë së banorëve për të respektuar procedurat e kycjes në rrjetin e ujësjellësit, furnizimi me ujë nuk ka filluar deri në fund të vitit 2019. Përmes takimeve të përbashkëta me të gjitha palët e interesit është bërë përpjekje dhe janë dhënë afate për përbushjen e obligimeve për secilin institucion bazuar në përgjegjësitë që ata kanë - ky proces është në vazhdim.
- **Matja dhe faturimi i sasisë së ujit të trajtuar me shumicë I cili furnizon pjesën veriore të Kosovës** – me qëllim të verifikimit të sasisë dhe matjes së ujit të trajtuar me shumicë, është zhvilluar inspektim në KRU "Mitrovica" me ç'rast janë inspektuar matësit e ujit si dhe të gjitha dokumentet relevante në bazë të të cilave është përpiluar Raporti I Inspektimit I cili I është përcjellë aksionarit (NjPMNP – MZHE)
- **Inspektimet në bazë të kërkesave të Komisionit për shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve** - lidhur me ankesat e parashtruara nga konsumatorët në Komisionin për shqyrtimin e ankesave janë zhvilluar dy inspektime në KRU "Prishtina", me ç'rast janë analizuar dokumentet dhe faktet e paraqitura nga përfaqësuesit e KRU "Prishtina" si dhe është zhvilluar inspektim në terren. Inspektimet kanë ndihmuar Komisionin në nxjerrjen e vendimeve.

5.11. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve dhe Komisionit për Zgjedhjen e Ankesave të Konsumatorëve

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, konform nenit 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-042, si dhe konform Nenit 5 të Rregullores për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr.01/2016), janë themeluar dhe kanë funksionuar Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK).

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve gjatë viti 2019 kanë këshilluar dhe rekomanduar Rregullatorin për çështjet me rëndësi në lidhje me ofrimin e shërbimeve. Kanë mbajtur 56 takime për të shqyrtuar dhe zgjedhur ankesat e konsumatorëve, të cilat nuk janë trajtuar në pajtim me dispozitat ligjore nga ofruesi i shërbimeve, si dhe kanë vendosur lidhur me ankesat e shqyrtuara të konsumatorëve. Në kuadër të ARRUsë, këto komisione janë të themeluara dhe kanë funksionuar në shtatë rajone të Kosovës, ku secila komunë brenda rajonit të përcaktuar e ka nga 1 (një) përfaqësues.

Anëtarët e këtyre komisioneve kanë qenë të zgjedhur sipas propozimeve të kryetarëve të komunave, pas intervistave dhe procedurave për përzgjedhjen e tyre dhe ka vepruar deri në korrik të vitit 2019.

Gjatë gjithë periudhës së funksionimit, Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve janë monitoruar dhe mbështetur nga ARRU.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 06/l -088 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 05/l-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, këto Komisione i kanë ndërprerë aktivitetet pasi që ligji ka paraparë shuarjen e këtyre Komisioneve. Pas shuarjes së këtyre Komisioneve, kompetenca për trajtimin e ankesave të konsumatorëve i ka kaluar Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.

Prandaj, në pajtim me nenin 5 të Rregullores Nr. 09/2019 për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve, ARRU ka themeluar Komisionin për Zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve I cili vepron në formën e organit në kuadër të Departamentit për Çështje Ligjore dhe Licencim, për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve dhe është organ përfundimtar në procedurën administrative. Komisioni është profesional

dhe i pavarur në trajtimin e ankesave dhe vendimmarrjen e tij. Komisioni shqyrton pranueshmërinë, ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë për ankesa të konsumatorëve, në përputhje me LPPA dhe ka nxjerrë vendim me shkrim për çdo ankesë të shqyrtuar. Komisioni gjatë shqyrtimit të ankesave sipas nevojë ka marr mendimin profesional të zyrtarëve tjerë në kuadër të Autoritetit, si dhe në shumë raste ka dalë në teren për vërtetimin e gjendjes faktike më kërkesë të konsumatorit.


Në shumë raste gjatë vitit 2019 në takime kanë marrë pjesë edhe konsumatorët, përfaqësues të departamentit për mbrojtje të konsumatorëve (MTI) , OJQ-të dhe mediat.

Në vijim është dhënë në formë tabelore dhe diagrami, numri i ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve dhe Komisioni për zgjidhjen e Ankesave të Konsumatorëve për të gjitha rajonet e Kosovës.

Tabela nr. 17 Numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët

RAJONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Gjithsej
Prishtinë	15	19	17	19	8	12	17	17	11	18	8	17	178
Mitrovicë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	2
Pejë	0	1	0	2	0	0	0	0	0	0	1	0	4
Gjakovë	12	3	3	4	5	8	0	0	0	2	2	2	41
Prizren	2	3	1	1	4	1	1	5	1	2	1	2	24
Ferizaj	1	4	1	3	2	3	0	1	1	1	2	1	20
Gjilan	5	3	1	0	2	0	0	1	2	2	3	0	19
Gjithsej	35	33	24	29	21	24	18	24	15	25	18	23	288

Numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët me përqindje (%)



Rezultati i shqyrtimit të ankesave të parashtruara:

Nga 288 ankesa të parashtruara, 264 janë zgjidhur, për 2 janë dërguar njoftim për palët me udhëzime për veprimet e mëtejme, për 10 ankesa janë nxjerrë vendime duke i hedhur poshtë të palejuara sepse Komisioni nuk ka qenë kompetent për shqyrtimin e tyre, për 11 ankesa Komisioni ka nxjerr vendim duke i hedhur poshtë të pa afat, sepse janë parashtruar jashtë afateve ligjore dhe 1 ankesë është tërhequr më kërkesë të palës.

Bazuar në analizimin më të hollësishëm të ankesave në vijim është paraqitur një përmbledhje e kategorizuar e ankesave:

a) Shpërndarja e ankesave sipas KKK regionale:

Siç shihet edhe nga tabela Nr. 15, numri më i madh i ankesave është evidentuar në KKK Prishtinë me 178 ankesa.

b) Natyra e ankesave:

- Kontestim i borxhit – 197 ankesa
- Zbritja apo shlyerja e borxhit – 36 ankesa
- Faturim paushall – 19 ankesa
- Moslexim i rregullt i ujëmatësit – 5 ankesa
- Të tjera – 31 ankesa

c) Kategoritë e konsumatorëve:

- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 242 ankesa janë nga konsumatorët shtëpiak;
- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 40 ankesa janë nga konsumatorët komercial/industrila;
- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 6 ankesa janë nga konsumatorët institucional

5.12. Aktivitetet në konsolidimin institucional

Në këtë kapitull janë paraqitur aktivitetet në fushën e legjislativit, të cilat ARRU i ka ndërmarrë gjatë vitit 2019 në pajtim me Planin Strategjik 2018-2020 dhe në bazë të obligimeve dhe kompetencave të cilat i ka.

5.12.1. Aktivitetet në planin legjislativ

Gjatë vitit 2019 përveç harmonizimit të akteve nënligjore me legjislacionin aktual (të cilat janë shpjeguar në kapitujt e mësipërm), ARRU ka hartuar edhe dokumente tjera siç janë:

5.12.1.1. Hartimi i planeve, raporteve, udhëzuesve dhe dokumenteve tjera .

- **Përpilimi i Planit të Punës 2020** – bazuar në planin Strategjik 2018 - 2020, në planet e punës së njësisë përkatëse të ARRU dhe me qëllim të definimit të aktiviteteve për vitin 2019, është përpiluar Plani i Punës së ARRU për vitin 2019. Ky plan paraqet aktivitetet e njëpasnjëshme të institucionit përgjatë periudhës njëvjecare, të cilat të ndërlidhura me njëra tjetrën kontribuojnë në arritjen e objektivave të ARRU.
- **Përpilimi i Raportit të punës për vitin 2018** – Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2019, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës Raportin vjetor të punës për vitin paraprak (2018). Raporti paraqet aktivitetet dhe arritjet e ARRU në përmbushjen e mandatit ligjor për vitin raportues, sipas Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit (Ligji Nr.05/L-42) si dhe një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.
- **Udhëzimi Administrativ për taksën e Licencimit** - Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 14 të Ligjit Nr.05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të Ujit, pas konsultave me MF lidhur me dëgjimet buxhetore dhe miratimin e buxhetit për vitin 2019 nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Drejtori i ARRU ka nxjerr Udhëzimin Administrativ i cili nuk ka hy në fuqi më 01 janar 2019. Lartësia e TVL për ofruesit e shërbimeve për vitin 2019 në total është 393,099.38 EURO.

5.12.1.2. Paralajmërimet dhe masat ndëshkuese

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve, gjatë vitit raportues, ARRU ka ndërmarrë këto masa:

- Për mospërmbushje të obligimeve të dala nga Raporti i inspektimit me qëllim të eliminimit të faturimit të konsumatorëve pa matje, janë proceduar Paralajmërimet në gjashtë KRU.

5.12.1.3. Proceset Gjyqësore

Gjatë vitit 2019 ka pasur shumë raste në gjykata, në të cilat ARRU ishte në cilësinë palës në procedurë për çështje të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar detalet e pjesëmarrjes së ARRU në procese gjyqësore duke përfshirë edhe detalet e zgjidhjes së këtyre rasteve nga gjykatat kompetente.

Siç edhe është pasqyruar në tabelën e mëposhtme, mos humbja e asnjë rasti në proceset gjyqësore është tregues i një performance të lartë të përfaqësimit të ARRU në kuptimin e përgaditjes së shkresave (padi, përgjigje në padi, propozime për përmbarim dhe ankesave).

Tabela nr. 18 proceset gjyqësore

Numri i seancave gjyqësore gjatë vitit 2019 të mbajtura në Gjykatën Themelore	Numri i padive të parashtruara nga konsumatorët dhe ofruesit të ujit gjatë vitit 2019	Numri i rasteve të fituara me Aktgjykim nga Gjykata Themelore lidhur me paditë	Numri i rasteve të fituara me Aktgjykim nga Gjykata e Apelit lidhur me paditë	Numri i rasteve të kthyer ne rivendosje nga Gjykata Themelore lidhur me paditë	Numri i rasteve të fituara me Aktgjykim nga Gjykata e Apelit lidhur me ofruesve të shërbimeve	Gjithsejtë Aktgjykim e gjatë vitit 2019 duke llogaritur edhe rastet e KRU-ve
41	23	21	5	5	2	33

5.13. Bashkëpunimi me Institucionet Tjera

Me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive në sektorin e ujit, gjatë tërë vitit ka vazhduar bashkëpunimi i ARRU me të gjitha palët e interesit (vendore dhe ndërkombëtare). Ky aktivitet nënkupton koordinimin e aktiviteteve, shkëmbimin e informatave, përvojave etj. Në vijim në pika të shkurta janë paraqitur institucionet me të cilat ARRU ka bashkëpunuar gjatë vitit raportues dhe përmbledhjen e shkurtër të qëllimit dhe aktiviteteve të ARRU me këto institucione:

- a) **Bashkëpunimi me Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor** - ARRU i është përgjigjur të gjitha kërkesave të këtij komisioni, me theks në dhënien e opinionit dhe arsyeshmërisë lidhur me amendamentet e propozuara nga të gjitha palët rreth Amandamentimin e Ligjit Nr. 05/L-042.
- b) **Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)**
Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007 edhe gjatë këtij viti ARRU ka vazhduar bashkëpunimin përmes një numri aktiviteteve siq është shkëmbimi i të dhënave për kualitetin e ujit, kontributit profesional të dhënë në takimet e mbajtura nga GNI në lidhje me përpilimin e Rregulloreve dhe procedurave të cilat dalin nga UA 16/2012- për kualitetin e ujit.
- c) **Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) të MZHE** – ARRU ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ofruesve të shërbimeve. Gjatë vitit 2019 kemi zhvilluar takime të përbashkëta me qëllim të zhvillimit të sektorit. Kemi qenë pjesëmarrës aktiv në grupin punues për certifikimin e bazuar në testim - I formuar dhe I udhëhequr nga MZHE me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Qeverisë së Kosovës dhe Shqipërisë. Kjo Marrëveshje synon zhvillimin e një programi të përbashkët për Trajnimin dhe Certifikimin e bazuar në Testim për fuqinë punëtore të sektorit të ujit të secilit prej vendeve që është i angazhuar në sigurimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizime në mënyrë të sigurt dhe të besueshme.
- d) **Bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropian (MIE)** – ARRU ka pregaditur dhe dorëzuar raportet sipas kërkesave të MIE për “Inputet e Raportit të KE-së për Kosovën”, për aktivitetet dhe progresin e ARRU, raport në të cilin përveç progresit sipas planifikimeve të aktiviteteve të ARRU raportohet edhe progresi i disa prej treguesve të sektorit të ujit në nivel vendi (shkalla e faturimit, arkëtim, niveli i humbjeve të ujit, mbulueshmëria me shërbime të ujit, investimet kapitale etj).

Gjatë vitit 2019, përfaqësuesit e ARRU kanë marrë pjesë në takime dhe punëtori të organizuara nga MIE për të përfituar nga eksperiencat e shteteve tjera lidhur me procesin e integrimi, për procedurat e pregaditjes së raporteve dhe mënyrës së raportimit.

- e) **Bashkëpunimi me MTI** – gjatë vitit 2019 bashkëpunimi me MTI është intensifikuar, duke qenë se përfaqësuesi i ARRU është anëtar i Këshillit për Mbrojtjen e Konsumatorëve. Kemi marrë pjesë në takimet e këtij këshilli dhe kemi dhënë kontributin tonë në të gjitha çështjet e inicuar nga ky këshill.
- f) **Bashkëpunimi me pushtetin lokal** – me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të favorshme për furnizim me ujë të konsumatorëve, ARRU ka mbajtur takime me Kryetarët e Komunave të Hanit të Elezit, Shtërpçës dhe Mamushës.
- g) **Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit Ndër- Ministror të Ujit (KNMU)** – janë mbajtur takime me tema të ndryshme lidhur me koordinimin e të gjitha palëve për aktivitetet në sektor. Bashkëpunim më i theksuar gjatë vitit 2018 me përfaqësuesit e kësaj zyre ka qenë lidhur me:
- Zvogëlimin e humbjeve të ujit,
 - Integrimin e Hanit të Elezit në KRU “Bifurkacioni”
 - Angazhim rreth adresimit të problemit të subjekteve të cilat nuk shfrytëzojnë ujin nga sistemet publike të ujësjellësit por shfrytëzojnë ujin drejtpërdrejt nga resursi ujor. Është formuar Grupi Punues në kuadër të KNMU, dhe çështja e këtyre subjekteve është duke u trajtuar nga të gjitha institucionet relevante (MMPH, AUV, KNMU, IKSHPK, KRU-të).
- h) **Bashkëpunimi me SHUKOS (Shoqata e Ujësjiellësve të Kosovës)** – ARRU ka marrë pjesë në punëtoritë dhe seminarët të cilat kjo shoqatë I ka organizuar në bashkëpunim me SHUKALB (Shoqata e ujësjellës kanalizimeve të Shqipërisë). Në punëtorinë e organizuar nga SHUKOS/SHUKALB, ARRU ka ndarë eksperiencat e veta përmes prezantimit me temën “Efekti i ARRU-së në përmirësimin e Shërbimeve të Ujit” Me ftesë të SHUKOS janë mbajtur edhe takime tjera ku janë diskutuar disa çështje të ndryshme me rëndësi për ofruesit e shërbimeve.
- i) **Bashkëpunimi me Entin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU), Shqipëri** – bashkëpunim I rregullt i formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Janë mbajtur takime dhe vizita të ndërsjellta me qëllim të shkëmbimit të përvojave për tema të ndryshme.
- j) **Bashkëpunimi me përfaqësuesit e donatorëve** (SDC, SCO, GTZ, KFË, USAID etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave në Kosovë. Janë mbajtur takime, shkëmbim i përvojave, informatave dhe pjesëmarrje në punëtori të ndryshme me interes për sektorin. Në kuadër të këtyre bashkëpunime, vlen të theksohet bashkëpunimi me DORSCH/CDI (projekti implementues i fazës V –të për rehabilitimin e sistemeve rurale të ujësjellësit, i financuar nga Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës). Edhe gjatë vitit 2019 ARRU ka pasur mbështetje institucionale (konsulencë) në kuadër të fazës VI-të të këtij projekti.
- k) **Bashkëpunimi me IAWD /DANUBIS** - në kuadër të benchmarkingut regional dhe ndërkombëtarë kemi raportuar në platformën e Kosovës në kuadër të DANUBIS.
- l) **Bashkëpunimi me WAREG** – ARRU është anëtar me të drejta të plota e shoqatës së rregullatorëve evropiane të ujit WAREG. Gjatë vitit 2019 kemi marrë pjesë në tri takime të Asamblesë së përgjithshme të WAREG, kemi dhënë kontribut dhe jemi angazhuar ne task forcat e kësaj shoqate rreth çështjeve të ngritura sa I përket:
- Përgatitja e propozimeve rreth planit 3 vjeçar të veprimit dhe taksës së anëtarësimit të WAREG;

- Përgatitjen e Raportieve për “Kornizat rregullatore të tarifave në vendet anëtare të WAREG-ut”
- Pjesëmarrje dhe ne Forumin Evropian të Rregullatorëve të Shërbimeve të Ujit – forum I mbajtur nën organizimin dhe udhëheqjen e WAREG-ut.

Prezantimet, shkëmbimi I përvojave dhe tendenca për unifikimin e rregullimit të shërbimeve të ujit në vendet e BE janë ndër objektivat kryesore të këtij forumi.

Me të gjitha palët (Kosovare dhe ato jashtë vendit) përmes takimeve të drejtpërdrejta, punëtorive dhe prezantimeve, ARRU ka dhënë kontribut duke paraqitur qëndrimin e vet lidhur me arritjet dhe ngecjet e sektorit. Bashkëpunimi me të gjitha palët gjithashtu na ka ndihmuar të informohemi me zhvillimin e sektorit dhe përvojat e vendeve tjera.

5.14. RELACIONET ME PUBLIKUN

5.14.1. Bashkëpunimi me media

Transparenca është një faktor që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmbushjen e misionit të ARRU. Për këtë arsye, ARRU punon vazhdimisht për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut.

Gjatë vitit 2019 gjithashtu komunikimi me mediat është realizuar nëpërmjet komunikatave të botuar në gazeta dhe media elektronike, si një komunikim i drejtpërdrejtë dhe transparent mbi problemet dhe zhvillimet që pëson sektori i ujit.

- **Komunikatat për shtyp**- njoftimi i publikut rreth aktiviteteve të rëndësishme të ARRU si: publikimi i Raportit të Performancës për ofruesit e shërbimeve të ujit për vitin 2018, publikimi i raportit të Hulumtimit të Opinioneve të Konsumatorëve për Shërbimet e Ujit në Kosovë, si dhe publikimi i Broshurës informuese për qytetarët.
- **Publikimi i orareve të takimeve të KKK**: me qëllim të informimit të konsumatorëve, sensibilizimit të opinionit për rolin e KKK-ve, si dhe për të inkurajuar konsumatorët për pjesëmarrje në takime të KKK. ARRU përmes gazetave ditore çdo muaj deri në muajin korrik kur dhe janë shuar KKK-të, ka publikuar orarin e takimeve mujore të KKK.
- **Njoftimet**:- njoftimi për gjithë qytetarët dhe grupet e interesit për pjesëmarrje në debatin publik lidhur me Rregulloren për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve; rregulloren për standardet minimale të shërbimeve të ujit, si dhe rregulloren për përcaktimin e tarifave të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Edhe gjatë vitit 2019, në mënyrë periodike është punuar për përditësimin e faqes zyrtare të ARRU-së, duke ofruar një pasqyrë sa më të saktë të informacioneve dhe zhvillimeve të rregullatorit (*Përmes ueb faqes www.arru-rks.org konsumatorët kanë mundësi të informohen detajsh lidhur me të gjitha aktivitetet e ARRU-së*).

6. REKOMANDIMET

Për të vazhduar përmirësimin dhe zhvillimin e sektorit të furnizimit me ujë si dhe për të avancuar edhe më tej performancën e ARRU është i domosdoshëm angazhimi i të gjitha institucioneve në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale, vetëdijesimi dhe angazhimi i konsumatorëve si dhe bashkëpunimi më i ngushtë i të gjitha palëve. Në këtë kontest rekomandojmë:

- Zbatimin dhe monitorimin e “Kornizës strategjike për zvogëlimin e ujit të pafaturuar” dhe planeve individuale të ofruesve të shërbimeve për zvogëlimin e ujit të pafaturuar.
- Integrimin e sistemeve rurale të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të në kuadër të ofruesve të licencuar të shërbimeve me theks të vecantë të sistemeve rurale të cilat gjenden brenda zonës së shërbimit të ofruesit të licencuar.
- Marrjen në menaxhim të sistemeve të kanalizimit të cilat aktualisht ekzistojnë dhe nuk menaxhohen nga ofruesi i licencuar përkatës në kuadër të zonave të shërbimit.
- Integrimin e sistemeve të ujësjellësit dhe kanalizimit të komunave të cilat aktualisht nuk përfshihen në zonën e shërbimit të asnjë ofruesi të licencuar të shërbimeve në kuadër të ofruesit të shërbimeve për zonën respektive
- Bashkëpunim dhe koordinim më i ngushtë i të gjitha palëve të interesit gjatë përcaktimit të prioritetëve dhe planifikimit të investimeve (Qeveria, Komunitat, Ofruesit e Shërbimeve, Donatorët, etj), me theks në zbatimin e Ligji Nr. 06/l -088 (neni 35/a) lidhur me investimet në sektorin e shërbimeve ujore
- Vendosjen dhe zbatimin e marrëveshjes së performancës ndërmjet Njësisë së Politikave dhe Monitorim për Ndërmarrjet Publike (MZHE) dhe Bordeve të Drejtorëve për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.
- Angazhim i të gjitha palëve në eliminimin e subjekteve të cilat shfrytëzojnë burime alternative të furnizimit me ujë aty ku ekziston mundësia e kyçjes në rrjetin e ujësjellësit i cili menaxhohet nga ofruesit e licencuar të shërbimeve
- Intensifikim i fushatave për vetëdijesimin e konsumatorëve në përmbushjen obligimeve të konsumatorëve.
- MZHE si aksionar i ofruesve të shërbimeve të ujit të kontrollojë dhe ndalojë punesimet e paplanifikuara dhe të pa aprovuara nga organet kompetente me planet perkatese te biznesit, duke pasur parasysh se aktualisht numri I të punësuarëve tek ofruesit e shërbimeve është shumë I madh

Aprovimi i këtyre rekomandimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe zbatimi i tyre nga të gjitha palët do të ndikojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve me ujë dhe ngritjen e nivelit të performancës së ofrueseve të shërbimeve.

7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, buxhetin e vet e siguron nga Buxheti i Kosovës, ndërsa Taksa Vjetore e Licencimit, e cila është e barabartë me shpenzimet buxhetore të ARRU-së, derdhet në buxhetin e Kosovës.

Të hyrat e planifikuara për vitin fiskal 2019 kanë qenë 393,099.38€ të inkasuara 355.976 € apo shprehur në përqindje 90.56%.

Borgjet nga vitet e kaluara të bartura në vitin 2019 janë në vlerë prej 240,541.68 euro prej të cilave 193,771.63 € janë nga kompanit e mbeturinave, të cilat deri në vitin 2012 janë licencuar ARRU, ndërsa pjesa e tjetër në vlerë prej 46,770.05€ janë nga vitet 2015-2017 nga KRU Mitrovica. Për vitin 2019 llogaritë e arkëtueshme janë me vlerë 37,004.76 nga KRU 'Mitrovica' dhe gjithsej borxhi për vitin 2019 është në vlerë 277,546.44 €.

Per të gjitha këto borgje ARRU ka ngritur padi gjyqesore dhe janë në proces të shqyrtimit

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për vitin 2019 ka qenë 1.09%, të faturimit bruto të KRU-ve apo shprehur në vlerë monetare 393,099.38€

Buxheti i planifikuar sipas ligjit të buxhetit për vitin 2019 ka qenë në vlerë prej 392,370.63 €, ndërsa buxheti final në fund të vitit ka qenë 358,169.87 €. Ky ndryshim ka ndodhur sipas kërkesës së Ministrit të Financave të aprovuar me vendimet e Kryeministrit Nr. 02/113 datë 05.11.2019 në kategorinë mallra dhe shërbime në vlerë prej 18,495.00 €, si dhe vendimi Nr. 03/115 i datës 17.12.2019 në kategorinë paga dhe meditare në vlerë prej 15,705.76 €

Me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit kompetencat për të zhvilluar procedurat e prokurimit kanë kaluar te AQP dhe kjo ka qenë pengesa kryesore në mos shfrytëzimin e buxhetit sipas planifikimit.

Tabela 19: Buxheti i ARRU për 2019

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	235,666.87	235,666.87
Mallra dhe shërbime	116,000.00	113,351.20
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,503.00	4,090.90
Total Buxheti	358,169.87	353,108.97

ARRU buxhetin e vitit 2019 e ka shpenzuar në 98.58%.

TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2019

Të hyrat nga TVL, shprehur në përqindje janë realizuar 90, 56%

Mosrealizimi I të hyrave është shkak I mospagesës së TVL per vitin 2019 nga KRU Mitrovica në vlerë prej 37,004.74 euro.

Tabela nr. 19 te hyrat nga TVL

Kategoria e Hyrave	Te faturuara (EUR)	Të inkasuara (EUR)
Te hyrat nga Taksa e Licencimit	393,099,38	355,976,00
Total Hyrat		355,976,00

Formatin e Raportit të detajuar financiar të aprovuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës të Kosovës e keni të bashkangjitur (aneksi 1)

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka audituar ARRU-në për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2018. Për vitin 2018 nuk kemi pasur asnjë rekomandim, ndërsa për vitin 2019 Auditimi i rregullsisë ende nuk është kryer nga ZKA.

Në ARRU në vitin 2019 për herë të parë nga ZKA është kryer auditimi i Performancës me temën "Sistemi i Përcaktimit të Tarifave të Energjisë Elektrike, Termike dhe atyre të Ujësjellësit".

ARRU menjëherë ka hartuar planin e veprimit dhe ka filluar me veprimet që do të ndërmerren për adresimin e rekomandimeve të dhëna në këtë raport të auditimit.

Shtojca 1: Raporti Financiar për vitin 2019 sipas formatit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Ali Pashë Tepelena, Nr. 1

E-mail: info@arru-rks.org

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>

